

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi limit pa TVSH në lekë	Periodha në muaj	Nr. Rojeve
1.	Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje civile të Spitalit Gjirokaster për vitin 2017	1,832.749,62	7.5 muaj	4.7

Të dhënat për përgatitjen e ofertës ekonomike.

Oferta të shoqërohet me një analizë kostoje ku te jenë të përfshira :

-shpenzimet për pagën e rojeve duke zbatuar ligjshmërinë që normon Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike për një sistemin të pandërprerë të punës, ditët kalendarike, ligjet, vendimet dhe udhëzimet në fuqi në lidhje me pagën baze minimale mujore, llogaritjen e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- pagesat për shtesat mbi pagën për turnin e dyta (ora 19.⁰⁰ - 22⁰⁰), shtesat mbi pagën për turnin e tretë (ora 22.⁰⁰ - 06⁰⁰), në zbatim të ligjit për Kodin e Punës.
- pagesat për shtesat mbi pagën për ditët e pushimeve dhe ditët e festave,
- shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit.
- të gjitha shpenzimet e përgjithshme,
- për uniformën (veshmbathjen),
- ndërlidhje (si radiomarrës etj),
- armatim
- si dhe të gjitha detyrimet fiskale që parashikon legjislacioni në fuqi,

(Në mënyrë që të mundësohet verifikimi i vlerave minimale nëse janë në përputhje me aktet ligjore e nenligjore në fuqi).

Autoriteti Kontrator do të skualifikoj të gjithë operatorët që kanë paraqitur vlerat e zerave të lartpërmendur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ofertat nën koston ligjore të përlogaritjes së çmimit do të konsiderohen të pavlefshme.

Përshkrimi i godinës së institucionit:

Godina qendrore dhe godina e Maternitetit, përfshirë edhe ambientin ku parkohen automjetet e institucionit. Vendndodhja: Lagjia "18 shtatori" Gjirokaster.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë do të përfshijë sigurimin e godinës dhe të ambjenteve për rreth institucionit.
- Kryerja e shërbimit të bëhet me 1 (një) vëndroje.
- Koha e shërbimit të jetë 24 orëshe (3 turne), për çdo ditë kalendarike;
- Të njihet dhe të respektohet rregullorja e Institucionit gjatë kohës së kryerjes së shërbimit.
- Rojet duhet të kenë në përdorim radio komunikimi për realizimin e shërbimit të ruajtjes.
- Rojet duhet të jenë të pajisur me uniformë, sipas legjislacionit në fuqi.

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

"Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike, me roje civile, të godinave të Spitalit Gjirokaster dhe të ambjenteve përreth godinës "

Përshkrimi kërkesave të zbatimit të shërbimit që kërkohet :

1. Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë do të përfshijë sigurimin e godinës dhe të ambjenteve për rreth ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti i Spitalit Gjirokaster, nga dëmtimet, vjedhjet e mundshme si dhe sigurimin e punës normale të administratës dhe të punonjësve të saj.
2. Kryerja e shërbimit të jetë 24 orë (nga ora 00.00 deri në orën 24.00) për çdo ditë kalendarike, sipas afateve të kontratës, me dy vendroje.
3. Punonjësit e shërbimit duhet :
 - Të jenë të pajisur me uniformë me siglën dalluese të shoqërisë dhe me dokument identifikimi personal për çdo punonjës shërbimi.
 - Të jenë të pajisur me mjete ndërlidhje për komunikim si për parandalimin dhe për ndalimin e veprimtarisë së keqbërësve në dëm të objektit që ka në ruajtje dhe nën pergjegjesinë personale të tij.
 - Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objektit.
 - Të sigurojë vendparkimin e ndodhur në ambjentet përreth godinës së Spitalit, dhe të ruhen nga shoqëria automjetet e institucionit dhe të punonjësve të Spitalit, si dhe të sigurohet parkimi i tyre sipas vendeve të përcaktuara nga institucioni.
 - Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjësën e rojeve dhe atë të objektit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
 - Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullësi të njoftojë me shkrim përgjegjësën e rojeve dhe atë të objektit.
 - Në rast zjarri të marrë masa për shuarjen e tij dhe menjëherë të njoftojë zjarrfikëset.
 - Kur në objekt kryhen vepra penale, roja të bëjë bllokimin e mjedisit si dhe të autorit dhe të njoftojë menjëherë organet kompetente.
 - Për marrjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 minuta para orarit. Atij i ndalohet largimi nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar.
 - Ndalohet qëndrimi i rojes në ambjentet e brendshme të institucionit, përjashtuar rasteve për zbatimin e rregullores.
 - Duhet të kontrollohet hyrja e vizitoreve tek pacientet dhe të lejohet vetëm në orarin e caktuar 10:00-12:00 dhe 16:00-18:00, me përjashtim të familjareve që kanë autorizim nga mjeku përkatës .
 - Roja gjatë kohës së shërbimit duhet të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me punonjësit, si dhe gjatë kohës së shërbimit i ndalohet përdorimi i pijeve alkoolike.
4. Në vend roje duhet të jenë: - Rregullorja e brendshme e institucionit.- Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit. -Grafiku i shërbimit. -Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike. -Numrat telefonike të rajoneve të policisë, zjarrfikëseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit (institucionit). -Lista e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në hapsirën e planifikuar për parkingun në territorin e objektit.
5. Shoqëria duhet të marrë përsiper zhdëmtimin 100% të dëmeve që vijnë për shkak të mos kryerjes si duhet të shërbimit, nga punonjësit e shoqërisë.